



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:222118

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06524923

C.nr.2023:222119

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI CIVIL, gjyqtarja Kreshnike Zymberi Beqiri me bashkëpunëtoren profesionale Ilirjana Hashani, në çështjen juridike kontestimore të iniciuar me padinë e paditësit A. I. me vendbanim në fshatin ...Komuna..., të cilin me autorizim e përfaqëson av.Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore, jashtë shqyrtimit gjyqësor, vlera e kontestit 380.00 euro, me datë 29 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHTË si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. I. ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e ... - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit për periudhën prej 03.10.2022 deri më 21.11.2022 në emër të shujtave ditore për 32 ditë pune të i kompensoj shumën prej 64.00€ (gjashtëdhjetë e katër euro), me kamatë ligjore prej 8% nga e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00€ (njëqind e njëzet e katër euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit me të cilën ka kërkuar që të kompensohet në emër të shujtave ditore për periudhën nga data 21.11.2022 deri më 07.07.2023 apo për 158 ditë pune 316.00€ (treqind e gjashtëmbëdhjetë euro), si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës me datë 19.10.2023, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, konform nenit 35 par. 7 KKAK -ës për periudhën kohore prej datës 03.10.2022 deri më 07.07.2023 .

Në referatin e padisë autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi në cilësinë e mësimit në shkollën në institucionet arsimore SH.F.M.U ‘...’ në fshatin ... Komuna dhe nuk ka pranuar mjetet e parapara për kompensimin e ushqimit (shujtave) në punë dhe atë në vlerë prej 2 euro në ditë të shpenzimeve, siç parashihet me nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e vitit 2017 dhe se e njëjta këtë kompensim është dashur ta pranojë nga e paditura së bashku me pagën mujore mirëpo e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija dhe të obligohet e paditura në përmbushjen e detyrimit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Gjykata, më dt.27.08.2021 të paditurës, i’ a ka dorëzuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padi, por e paditura, ndonëse i ka pranuar shkresat me rregull (provë: fletëkthesa e nënshkruar nga e paditura me datë 27.08.2021) brenda afatit të caktuar ligjor, e as deri në këto momente, nuk ka ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e saj nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa gjykata nga provat e çështjes, ka gjetur se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësi.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësinë për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata përmes kontratës së punës për mësimit në shkollën me numër të protokollit 05/ e datës 01.09.2020, ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune në SHFMU ‘...’ në fshatin Komuna ... në vendin e punës mesues klase, nga vërtetimi i lëshuar nga drejtoria e shkollës me numër protokollit 1419/1 i datës 07.07.2023 është vërtetuar se fakti se paditësi ka qenë prezent në punë për 190 ditë pune, për periudhën 03.10.2022 deri më 07.07.2023 .

Kontratën e punës për mësimit dhe vërtetimin e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet

se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimin e lëshuar nga ana e SHFMU ‘... “ si prova me të cilat vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditësit, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga e cila vërtetoi faktin se paditësi ka qenë në vendin e tij të punës nga data 03.10.2022 deri më 21.11.2022 apo gjithsej për 32 ditë pune.

Po ashtu në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e vitit 2017 e më saktësisht në dispozitën 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se “Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si mësimdhënës t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësit, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, dhe këtu i ka njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka refuzuar kërkesën e paditësit me të cilën ka kërkuar që të kompensohet për periudhën 22.11.2022 deri më 07.07.2023 apo për 158 ditë pune, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit ka qenë në fuqi deri më datë 22.11.2022, andaj kërkesën e paditësit për periudhën jashtë kësaj kontrate nuk gjen mbështetje ligjore për kompensimin e shujtave ditore, andaj dhe ka refuzuara këtë pjesë të padisë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e plotfuqishmerise të padisë në këtë gjykatë , bazuar në

Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104 euro për përpilimin e padisë si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 20 euro, gjithsej shumë prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.2023:222119 me datë 29 nëntor 2024

Gjyqtarja
Kreshnike Zymeri Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.